



# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr. 2

2002

Shkurt

## P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr.8853 datë 31.1.2002	Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në "Konventën ndërkombëtare për mbrojtjen fizike të materialeve bërthamore"	19
Ligj nr.8854 datë 31.1.2002	Për ratifikimin e "Protokollit të bisedimeve ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunimin financiar dhe teknik për vitin 2001".....	28
Ligj nr.8855 datë 31.1.2002	Për ratifikimin e "Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për shtyrjen e pagesave të borxhit" (Marrëveshja "Shqipëria III") .....	35
Dekret nr.3231 datë 22.1.2002	Për lejim lënie të shtetësisë shqiptare.....	46
Vendim i Kuvendit nr.15, datë 21.1.2002	Për krijimin e Komisionit të Posaçëm të Kuvendit për shqyrtimin e rekomandimeve të OSBE-së/ODIHR-it për zgjedhjet parlamentare të vitit 2001.....	47
Vendim i Kuvendit nr.16, datë 31.1.2002	Për zgjedhjen e Zëvendëskryetarit të Kuvendit.....	47

**LIGJ**  
**Nr. 8853, datë 31.1.2002**

**PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË "KONVENTËN  
NDËRKOMBËTARE PËR MBROJTJEN FIZIKE TË MATERIALEVE BËRTHAMORE"**

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**K U V E N D I**

**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË  
V E N D O S I:**

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në "Konventën ndërkombëtare për mbrojtjen fizike të materialeve bërthamore" të 3 marsit 1980.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.3250, datë 2.2.2002 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani**

**KONVENTA**  
**MBI MBROJTJEN FIZIKE TË MATERIALIT BËRTHAMOR**

1. Konventa mbi mbrojtjen fizike të materialit bërthamor u hap për nënshkrim më 3 mars 1980 në përputhje me nenin 18.1 të saj dhe pason përfundimin e bisedimeve më 28 tetor 1979.

2. Tekstet e Konventës (1) dhe të Aktit Përfundimtar të Mbledhjes së përfaqësuesve qeveritarë për të shqyrtuar hartimin e Konventës janë riprodhuar në këtë dokument për njoftim të gjitha Shteteve Anëtare.

3. Shtetet Anëtare do të informohen me anë të një shtojce të këtij dokumenti për hyrjen në fuqi të Konventës, në përputhje me nenin 19.1 të saj.

**KONVENTA**  
**MBI MBROJTJEN FIZIKE TË MATERIALIT BËRTHAMOR**

Shtetet Palë në këtë Konventë:

Duke njohur të drejtën e të gjitha shteteve për zhvillimin dhe përdorimin e energjisë bërthamore për qëllime paqësore dhe interesat e tyre legjitime në përfitimet potenciale që rrjedhin nga përdorimi paqësor të energjisë bërthamore;

Të bindur për nevojën e lehtësimit të bashkëpunimit ndërkombëtar në përdorimin paqësor i energjisë bërthamore;

Duke dëshiruar të shmangim rreziqet e mëdha që shkaktohen nga marrja dhe përdorimi i paligjshëm i materialit bërthamor;

Të bindur se shkeljet që lidhen me materialin bërthamor janë çështje me shqetësim të madh dhe se ekziston një nevojë urgjente për miratimin e masave të përshtatshme dhe efektive për të siguruar parandalimin, zbulimin dhe ndëshkimin e shkeljeve të tilla;

Të vetëdijshëm për nevojën e bashkëpunimit ndërkombëtar për të vendosur, në përputhje me të drejtën kombëtare të çdo Shteti Palë dhe me këtë Konventë, masa efikase për mbrojtjen fizike të materialit bërthamor;

Të bindur se kjo Konventë do të lehtësojë lëvizjen e sigurt të materialit bërthamor;

Duke theksuar, gjithashtu, rëndësinë e mbrojtjes fizike të materialit bërthamor në përdorimin civil, magazinimin dhe transportimin;

Duke njohur rëndësinë e mbrojtjes fizike efektive të materialit bërthamor të përdorur për qëllime ushtarake dhe duke kuptuar se një material i tillë i jepet dhe do të vazhdojë t'i jepet mbrojtje fizike e rreptë,

Kanë rënë dakort si më poshtë:

#### Neni 1

Për qëllimet e kësaj Konvente:

a) "material bërthamor" nënkupton plutonin, përveç atij me përqendrim izotopik që i kalon 80% në plutonin - 238, uranin - 233, uranin e pasuruar me izotope 235 ose 233, uranin që përmban përzierje izotopeshe që ndodhet në natyrë, ndryshe nga forma e xeheronit (mineralit) ose mbeturina e xeheronit (mineralit); çdo material që përmban një ose më shumë nga ato që përmendëm më lart;

b) "uran i pasuruar me izotope 235 ose 233" nënkupton uran që përmban izotope 235 ose 233 ose të dy, në një sasi të tillë që raporti i përmbajtjes së shumës së këtyre izotopeve në izotopin 238 është më i madh se raporti i izotopit 235 ndaj izotopit 238 që ndodhet në natyrë;

c) "transporti bërthamor ndërkombëtar" nënkupton transportin e një ngarkese të materialit bërthamor me anë të çdo mjeti të transportit, i destinuar të shkojë përtej territorit të shtetit ku ngarkesa ka prejardhjen, duke filluar me nisjen nga një mjet i dërguesit në atë shtet dhe duke përfunduar me arritjen në një mjet të marrësit brenda shtetit të destinacionit të fundit.

#### Neni 2

1. Kjo Konventë do të zbatohet për materialet bërthamore të përdorura për qëllime paqësore gjatë transportit bërthamor ndërkombëtar.

2. Me përjashtim të neneve 3 dhe 4 dhe të paragrafit 3 të nenit 5, kjo Konventë, gjithashtu, do të zbatohet për materialet bërthamore të përdorura për qëllime paqësore që janë në përdorim civil, magazinim dhe transportim.

3. Me përjashtim të angazhimeve të marra qartë nga Shtetet Palë në nenet e mbuluara nga paragrafi 2 në lidhje me materialet bërthamore të përdorura për qëllime paqësore, që janë në përdorim civil, magazinim dhe transportim, asgjë në këtë Konventë nuk do të interpretohet se ndikon në të drejtat sovrane të një shteti lidhur me përdorimin civil, magazinimin dhe transportimin e një materiali të tillë bërthamor.

#### Neni 3

Çdo Shtet Palë do të marrë hapat e duhur, brenda kuadrit të së drejtës së tij kombëtare dhe në përputhje me të drejtën ndërkombëtare, për të siguruar aq sa është e praktikueshme se, gjatë transportit bërthamor ndërkombëtar, materiali bërthamor, brenda territorit të tij ose në bordin e një anijeje ose avioni nën juridiksionin e tij, në masën që një avion ose anije e tillë është angazhuar në transportin për ose nga ai shtet, është mbrojtur në nivelet e përshkruara në Aneksin 1.

#### Neni 4

1. Çdo Shtet Palë nuk do të eksportojë ose autorizojë eksportin e materialit bërthamor, përveçse kur Shteti Palë ka marrë sigurimet se një material i tillë do të mbrohet gjatë transportit bërthamor ndërkombëtar në nivelet e përshkruara në Aneksin 1.

2. Çdo Shtet Palë nuk do të importojë ose autorizojë importin e materialit bërthamor nga një Shtet që nuk është Palë në këtë Konventë, përveçse kur Shteti Palë ka marrë sigurimet se një material i tillë do të mbrohet gjatë transportit bërthamor ndërkombëtar në nivelet e përshkruara në Aneksin 1.

3. Një Shtet Palë nuk do të lejojë kalimin tranzit të territorit të tij nga toka ose ujërat e brendshme ose nëpërmjet aeroporteve të tij ose porteve detare të materialit bërthamor ndërmjet shteteve që nuk janë Palë të kësaj Konvente, përveçse kur Shteti Palë ka marrë sigurimet në masën që janë të praktikueshme, që ky material bërthamor do të mbrohet gjatë transportit bërthamor ndërkombëtar në masat e përshkruara në Aneksin 1.

4. Çdo Shtet Palë do të zbatojë, brenda kuadrit të së drejtës së tij kombëtare, nivelet e mbrojtjes fizike të përshkruara në Aneksin 1 për materialin bërthamor që transportohet nga një zonë e atij shteti në një zonë tjetër të të njëjtit shtet, nëpërmjet ujërave ndërkombëtare ose hapësirës ajrore.

5. Shteti Palë përgjegjës për marrjen e sigurimeve se materiali bërthamor do të mbrohet në nivelet e përshkruara në Aneksin 1, sipas paragrafëve nga 1 deri në 3, duhet të identifikojë dhe të njoftojë përpara shtetet në të cilat materiali bërthamor pritet të kalojë tranzit nga toka ose ujërat e brendshme, ose shtetet në aeroportet ose portet detare të të cilave pritet të hyjë.

6. Përgjegjësia për marrjen e sigurimeve të përmendura në paragrafin 1 mund t'i kalohet, me marrëveshje të përbashkët, Shtetit Palë të përfshirë në transport si shteti importues.

7. Asgjë në këtë nen nuk duhet të interpretohet se ndikon, në çdo mënyrë, në sovranitetin territorial dhe juridiksionin e një shteti, duke përfshirë atë mbi hapësirën e tij ajrore dhe ujërat e tij territoriale.

## Neni 5

1. Shtetet Palë duhet t'i identifikojnë ose bëjnë të njohur njëri-tjetrit, drejtpërdrejt ose nëpërmjet Agjencisë Ndërkombëtare të Energjisë Bërthamore, autoritetin e tyre qendror dhe pikën e kontaktit që ka përgjegjësinë për mbrojtjen fizike të materialit bërthamor dhe për koordinimin e veprimeve të zbulimit dhe të operacioneve kundërvepruese, në rast të ndonjë lëvizje të paautorizuar, përdorimit ose ndryshimit të materialit bërthamor ose në rast të kërcënimit të mundshëm për të.

2. Në rast vjedhjeje, grabitjeje ose ndonjë marrjeje tjetër të paligjshme të materialit bërthamor ose të kërcënimit të mundshëm për të, Shtetet Palë, në përputhje me të drejtën e tyre kombëtare, do t'i sigurojnë bashkëpunimin dhe ndihmën në masën maksimale të realizueshme në zbulimin dhe mbrojtjen e materialit të tillë, çdo shteti që e kërkon atë. Në veçanti:

a) një Shtet Palë duhet të marrë hapat e duhura për të informuar, sa më shpejt që të jetë e mundur, shtetet e tjera, të cilat i duken atij të interesuara për ndonjë vjedhje, grabitje ose marrje tjetër të paligjshme të materialit bërthamor ose kërcënimin të mundshëm për të dhe të njoftojë, kur është e përshtatshme, organizatat ndërkombëtare;

b) aq sa është e përshtatshme, Shtetet Palë të interesuara duhet të shkëmbejnë informacion me njëri-tjetrin ose organizatat ndërkombëtare, me synim mbrojtjen e materialit bërthamor të kërcënuar, duke verifikuar integritetin e kontenierit transportues ose zbulimin e materialit bërthamor të marrë në mënyrë të paligjshme dhe:

I. do të koordinojë përpjekjet e tyre nëpërmjet kanaleve diplomatike dhe mënyrave të tjera të rëna dakord;

II. do të ofrojnë ndihmë, në qoftë se kërkohet;

III. do të sigurojnë kthimin e materialit bërthamor të vjedhur ose që mungon, si pasojë e veprimeve të përmendura më sipër.

Mjetet e zbatimit të këtij bashkëpunimi do të përcaktohen nga Shtetet Palë të interesuara.

3. Shtetet Palë duhet të bashkëpunojnë dhe konsultohen, aq sa është e përshtatshme, drejtpërsëdrejti me njëri-tjetrin ose nëpërmjet organizatave ndërkombëtare, me qëllim që të marrin udhëzime mbi modelin, mirëmbajtjen dhe përmirësimin e sistemeve të mbrojtjes fizike të materialit bërthamor në transport ndërkombëtar.

## Neni 6

1. Shtetet Palë do të marrin masat e përshtatshme, në përputhje me të drejtën e tyre kombëtare, për të mbrojtur konfidencialitetin e informacionit që ata marrin në besim në sajë të klauzolave të kësaj Konvente nga një Shtet tjetër Palë ose nëpërmjet pjesëmarrjes në një aktivitet të organizuar për zbatimin e kësaj Konvente. Në qoftë se shtetet i japin informacion organizatave ndërkombëtare në besim, duhet të merren masa për t'u siguruar se konfidencialiteti i një informacioni të tillë është i mbrojtur.

2. Shteteve Palë nuk do t'i kërkohet, me anë të kësaj Konvente, të japin ndonjë informacion të cilin atyre nuk u lejohet që ta japin sipas të drejtës së tyre kombëtare ose që do të rrezikonte sigurinë e shtetit të interesuar ose mbrojtjen fizike të materialit bërthamor.

## Neni 7

1. Kryerja e qëllimshme e:

a) një veprimi pa autoritetin e ligjshëm që krijon marrja, zotërimi, përdorimi, transferimi, ndryshimi, asgjësimi ose zhdukja e një materiali bërthamor dhe që pastaj shkakton ose mund të shkaktojë vdekjen ose dëmtimin serioz të një personi ose dëmtim të konsiderueshëm të pasurisë;

b) një vjedhjeje ose grabitjeje të materialit;

c) përvetësimi ose sigurimit me mashtrim bërthamor të një materiali bërthamor;

d) një akti që përbën një kërkesë për material bërthamor me anë të kërcënimit ose përdorimit të forcës ose me anë të një forme tjetër kërcënimi;

e) një kërcënimi:

I. për të përdorur materialin bërthamor për të shkaktuar vdekjen ose dëmtimin serioz të ndonjë personi ose dëmtimin e konsiderueshëm të pasurisë; ose

II. kryerjen e ndonjë shkeljeje të përshkruar në nënparagrafin (b) me qëllim që të detyrojë një person fizik ose juridik, organizatë ndërkombëtare ose shtet për të kryer ose për të penguar kryerjen e ndonjë akti;

f) një përpjekje për të kryer ndonjë shkelje të përshkruar në paragrafët (a), (b) ose (c); dhe

g) një veprim i cili përbën pjesëmarrje në ndonjë nga shkeljet e përshkruara në paragrafët nga (a) deri te (f);

do të cilësohen shkelje të dënueshme nga çdo Shtet Palë sipas të drejtës së tyre kombëtare.

2. Çdo Shtet Palë do t'i bëjë shkeljet e përshkruara në këtë nen të dënueshme me dënime të përshtatshme, të cilat do të marrin parasysh natyrën e tyre të rëndë.

## Neni 8

1. Çdo Shtet Palë duhet të marrë masa të tilla që mund të jenë të nevojshme për të vendosur juridiksionin e tij mbi krimet e përcaktuara në nenin 7 në rastet e mëposhtme:

(a) kur krimi kryhet në territorin e atij shteti ose në bordin e një anijeje ose avioni të regjistruar në atë shtet;

(b) kur shkelësi i pretenduar është shtetas i atij shteti.

2. Çdo Shtet Palë duhet, gjithashtu, të marrë masa të tilla që mund të jenë të nevojshme për të vendosur juridiksionin e tij mbi këto shkelje, në rastet ku shkelësi i pretenduar ndodhet në territorin e tij dhe ai nuk e ekstradon atë, në përputhje me nenin 11, në ndonjë nga shtetet e përmendura në paragrafin 1 të këtij neni.

3. Kjo Konventë nuk përjashton ndonjë juridiksion penal të ushtruar në përputhje me të drejtën kombëtare.

4. Përveç Shteteve Palë të pretenduara në paragrafët 1 dhe 2, çdo Shtet Palë mundet, në përputhje me të drejtën ndërkombëtare, të vendosë juridiksionin e tij mbi shkeljet e përcaktuara në nenin 7 kur ai përfshihet në transportin ndërkombëtar bërthamor si shtet eksportues ose importues.

## Neni 9

Pasi i binden se rrethanat e përligjin një gjë të tillë, Shteti Palë, në territorin e të cilit shkelësi i pretenduar është i pranishëm, duhet të marrë masat e përshtatshme sipas të drejtës së tij të brendshme, në mënyrë që të sigurohet prania e tij për qëllimin e procedimit ose ekstradimit. Masat e marra sipas këtij neni duhet t'u njoftohen pa vonesë shteteve që i kërkohet të vendosin juridiksionin në përputhje me nenin 8 dhe ku është e përshtatshme të gjitha shteteve të tjera të interesuara.

## Neni 10

Shteti Palë, në territorin e të cilit shkelësi i pretenduar është i pranishëm, duhet, në qoftë se ai nuk e ekstradon atë, të paraqesë rastin, pa asnjë lloj përjashtimi dhe pa vonesa të pajustificuara, autoriteteve të tij kompetente me qëllim hetimi, sipas procedurave në përputhje me ligjet e atij shteti.

## Neni 11

1. Shkeljet në nenin 7 do të përcaktohen për t'u përfshirë si shkelje të ekstradueshme në ndonjë traktat ekstradimi që ekziston midis Shteteve Palë. Shtetet Palë marrin përsipër t'i përfshijnë këto shkelje si shkelje të ekstradueshme në çdo traktat të ardhshëm ekstradimi, që do të lidhet ndërmjet tyre.

2. Në qoftë se një Shtet Palë, që e kushtëzon ekstradimin me ekzistencën e një marrëveshjeje, merr një kërkesë për ekstradim nga një Shtet tjetër Palë me të cilin ai nuk ka marrëveshje ekstradimi, ai mundet në opsionin e tij ta konsiderojë këtë Konventë si bazë ligjore për ekstradimin në lidhje me këto shkelje.

Ekstradimi do t'i nënshtrohet dispozitave procedurale dhe kushteve të tjera ligjore të së drejtës së shtetit që i kërkohet.

3. Shtetet Palë, të cilët nuk e kushtëzojnë ekstradimin me ekzistencën e ndonjë marrëveshjeje, do t'i njohin këto shkelje si të ekstradueshme ndërmjet njëri-tjetrit, duke iu nënshtuar dispozitave të parashikuara të së drejtës së shtetit që i kërkohet.

4. Secila nga shkeljet do të trajtohet, për qëllimin e ekstradimit ndërmjet Shteteve Palë, sikur të jetë kryer jo vetëm në vendin në të cilin ajo ndodhi, por gjithashtu në territoret e shteteve që u kërkohet të vendosin juridiksionin e tyre në përputhje me paragrafin 1 të nenit 8.

## Neni 12

Çdo personi në lidhje me të cilin po kryhen procedurat mbi ndonjë nga shkeljet e përcaktuara në nenin 7 duhet t'i garantohet trajtimi i drejtë në të gjitha fazat e procedimit.

## Neni 13

1. Shtetet Palë duhet t'i japin njëri-tjetrit masën më të madhe të ndihmës në lidhje me procedimet penale të filluara lidhur me shkeljet e përcaktuara në nenin 7, duke përfshirë dhënien e provave në dispozicion të tyre të nevojshme për procedimin. Ligji i Shtetit të kërkuar do të zbatohet në të gjitha rastet.

2. Dispozitat e paragrafit 1 nuk do të ndikojnë mbi detyrimet sipas ndonjë traktati tjetër dypalësh ose shumëpalësh që rregullojnë ose do të rregullojnë, tërësisht ose pjesërisht, ndihmën e përbashkët në çështje penale.

## Neni 14

1. Çdo Shtet Palë do të njoftojë depozituesin për ligjet dhe rregullat e tij, të cilat i japin efekt kësaj Konvente.

Depozituesi duhet t'ia komunikojë një informacion të tillë periodikisht të gjitha Shteteve Palë.

2. Shteti Palë, ku shkelësi i pretenduar ndiqet penalisht, duhet, kurdoherë që është e praktikueshme, së pari t'ia komunikojë rezultatin përfundimtar të gjykimit shteteve direkt të interesuara. Shteti Palë duhet, gjithashtu, t'i njoftojë rezultatin përfundimtar depozituesit, i cili duhet t'ua transmetojë këtë informacion të gjithë shteteve të tjera.

3. Kudo ku shkelja përfshin material bërthamor të përdorur për qëllime paqësore në përdorim civil, magazinimin ose transportimin dhe si shkelësi i pretenduar, ashtu edhe materiali bërthamor qëndrojnë në territorin e Shtetit Palë në të cilin shkelja u krye, asnjë në këtë Konventë nuk do të interpretohet se i kërkon atij Shteti Palë të japë informacion lidhur me procedurat penale, që rrjedhin prej një shkeljeje të tillë.

#### Neni 15

Anekset përbëjnë një pjesë integrale të kësaj Konvente.

#### Neni 16

1. Një konferencë e Shteteve Palë do të thirret nga depozituesi pesë vjet pas hyrjes në fuqi të Konventës për të parë zbatimin e Konventës dhe përshtatjen e saj me kohën lidhur me parathënien, tërë pjesën operative dhe anekset në dritën e situatës që mbizotëronte atëherë.

2. Pas kësaj, në intervale kohe jo më pak se 5 vjet, shumica e Shteteve Palë mund të arrijnë thirrjen e konferencave të mëtejshme me të njëjtin objektiv, duke i paraqitur depozituesit një propozim për këtë qëllim.

#### Neni 17

1. Në rast të mosmarrëveshjeve midis dy ose më shumë Shteteve Palë lidhur me interpretimin ose zbatimin e kësaj Konvente, këto Shtete Palë do të konsultohen me qëllim që të zgjidhin mosmarrëveshjet nëpërmjet bisedimeve ose me anë të ndonjë mjeti tjetër paqësor për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, të pranuar nga të gjitha Palët në mosmarrëveshje.

2. Çdo mosmarrëveshje e këtij karakteri, që nuk mund të zgjidhet në mënyrën e përshkruar në paragrafin 1 duhet, por me kërkesën e ndonjë Pale në këtë mosmarrëveshje, t'i paraqitet arbitrazhit ose t'i drejtohet Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë për vendin që ka shkaktuar mosmarrëveshjen. Kur një mosmarrëveshje i paraqitet arbitrazhit, në qoftë se brenda gjashtë muajve nga data e kërkesës, Palët në mosmarrëveshje nuk janë në gjendje të bien dakord mbi organizimin e arbitrazhit, një Palë mund t'i kërkojë Presidentit të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë ose Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara të caktojnë një ose më shumë arbitra. Në rastin e kërkesave konfliktuese nga Palët në mosmarrëveshje, kërkesa për Sekretarin e Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara do të ketë përparësi.

3. Çdo Shtet Palë mundet që, në kohën e nënshkrimit, ratifikimit, pranimit ose miratimit të kësaj Konvente ose aderimit, të deklarojë se ai nuk e konsideron veten të detyruar nga njëra ose të dyja procedurat për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të parashikuara në paragrafin 2. Shtetet e tjera Palë nuk do të jenë të detyruara nga procedura e zgjidhjes së një mosmarrëveshjeje të parashikuar në paragrafin 2, në lidhje me një Shtet Palë që ka bërë një rezervim për atë procedurë.

4. Çdo Shtet Palë që ka bërë një rezervim sipas paragrafit 3 mund në çdo kohë ta tërheqë atë me anë të njoftimit drejtuar depozituesit.

#### Neni 18

1. Kjo Konventë do të jetë e hapur për nënshkrim nga të gjitha shtetet në Selinë e Agjencisë Ndërkombëtare të Energjisë Bërthamore në Vjenë dhe në Selinë e Kombeve të Bashkuara në Nju Jork nga 3 mars 1980 deri në hyrjen e saj në fuqi.

2. Kjo Konventë i nënshtrohet ratifikimit, pranimit ose miratimit nga shtetet nënshkruese.

3. Pas hyrjes së saj në fuqi, kjo Konventë do të jetë e hapur për aderim nga të gjitha shtetet.

(a) Kjo Konventë do të jetë e hapur për nënshkrim ose aderim nga organizatat ndërkombëtare dhe organizatat rajonale të integritit ose të një natyre tjetër, me kusht që çdo organizatë e tillë përbëhet nga shtete sovrane dhe ka kompetencë në lidhje me bisedimin, përfundimin dhe zbatimin e marrëveshjeve ndërkombëtare në çështjet që mbulohen nga kjo Konventë.

(b) Në çështjet brenda kompetencës së tyre, organizata të tilla duhet, në emër të tyre, të ushtrojnë të drejtat dhe të përmbushin përgjegjësitë që kjo Konventë i njeh Shteteve Palë.

(c) Kur bëhet Palë në këtë Konventë, një organizatë e tillë do t'i komunikojë depozituesit një deklaratë, që tregon se cilat shtete janë anëtare të saj dhe cilat nene të kësaj Konvente nuk zbatohen në të.

(d) Një organizatë e tillë nuk duhet të mbajë ndonjë votë shtesë, përveç atyre të Shteteve Anëtare të saj.

5. Instrumentet e ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit do të depozitohen pranë depozituesit.

#### Neni 19

1. Kjo Konventë do të hyjë në fuqi në të tridhjetën ditë pas ditës së depozitimit të instrumentit të njëzet e një të ratifikimit, pranimit ose miratimit pranë depozituesit.

2. Për çdo shtet që ratifikon, pranon, miraton ose aderon në Konventë pas datës së depozitimit të instrumentit të njëzet e një të ratifikimit, pranimit ose miratimit, Konventa do të hyjë në fuqi në të tridhjetën ditë pas ditës së depozitimit nga ky shtet të instrumentit të tij të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit.

#### Neni 20

Pa paragjykuar nenin 16, një Shtet Palë mund të propozojë ndryshime të kësaj Konvente. Ndryshimi i propozuar do t'i paraqitet depozituesit, i cili do ta qarkullojë atë menjëherë te të gjitha Shtetet Palë. Në qoftë se shumica e Shteteve Palë i kërkojnë depozituesit të thërrasë një Konferencë për të shqyrtuar ndryshimet e propozuara, depozituesi do të ftojë të gjitha Shtetet Palë në këtë Konferencë, që do të fillojë jo më shpejt se tridhjetë ditë pas bërjes së ftesave. Çdo ndryshim i miratuar në Konferencë nga dy të tretat e shumicës së Shteteve Palë, do të qarkullohet menjëherë nga depozituesi të gjitha Shteteve Palë.

2. Ndryshimi do të hyjë në fuqi për çdo Shtet Palë që depoziton instrumentin e tij të ratifikimit, pranimit, miratimit të ndryshimit në të tridhjetën ditë pas ditës në të cilën dy të tretat e Shteteve Palë kanë depozituar instrumentin e tyre të ratifikimit, pranimit, miratimit pranë depozituesit. Pas kësaj, ndryshimi do të hyjë në fuqi për çdo Shtet tjetër Palë në ditën në të cilën ky Shtet Palë depoziton instrumentin e tij të ratifikimit, pranimit, miratimit të ndryshimit.

#### Neni 21

1. Çdo Shtet Palë mund ta denoncojë këtë Konventë me anë të njoftimit të shkruar drejtuar depozituesit.

2. Denoncimi do të hyjë në fuqi njëqind e tetëdhjetë ditë pas ditës në të cilën është marrë njoftimi nga depozituesi.

#### Neni 22

Depozituesi do të njoftojë menjëherë të gjitha shtetet për:

a) çdo nënshkrim të kësaj Konvente;

- b) çdo depozitim të një instrumenti të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit;
- c) çdo rezervë ose tërheqje të saj në përputhje me nenin 17;
- d) çdo komunikim të bërë nga një organizatë, në përputhje me paragrafin 4 të nenit 18;
- e) hyrjen në fuqi të Konventës;
- f) hyrjen në fuqi të çdo ndryshimi në këtë Konventë;
- g) çdo denoncim të bërë në përputhje me nenin 21.

## Neni 23

Origjinali i kësaj Konvente, mbi të cilën tekstet në gjuhën arabe, kineze, anglisht, frëngjisht, rusisht dhe spanjisht janë njëloj autentike, do të depozitohen pranë Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë Ndërkombëtare të Energjisë Bërthamore, i cili do t'i dërgojë kopje të certifikuara të gjitha shteteve.

Në dëshmi të kësaj, nënshkruesit e autorizuar në mënyrën e duhur nga Qeveritë e tyre përkatëse, e kanë nënshkruar këtë Konventë, të hapur për nënshkrim në Vjenë dhe Nju Jork, më 3 mars 1980.

## ANEKSI (SHTOJCA) I

Nivelet e mbrojtjes fizike për të zbatuar në transportin ndërkombëtar të materialit bërthamor siç karakterizohet në Aneksin (shtojcën) II

1. Nivelet e mbrojtjes fizike për materialin bërthamor gjatë magazinimit (ruajtjes) identik (i njëjtë) me transportin ndërkombëtar bërthamor përfshijnë:

a) për materialet e kategorisë III, magazinimin (ruajtjen) brenda një zone në të cilën kontrollohet aksesimi (afrimi);

b) për materialet e kategorisë II, magazinimi (ruajtja) brenda një zone nën mbikqyrje të vazhdueshme me roje ose pajisje elektronike, rrethuar nga një barrierë (pengesë) fizike me një numër të kufizuar të pikave të hyrjes nën kontrollin e duhur ose ndonjë zonë me nivel të njëjtë të mbrojtjes fizike,

c) për materialin e kategorisë I, magazinimi (ruajtja) brenda një zone të mbrojtjes si kategoria II më sipër, në të cilën, përveç kësaj aksesimi i kufizohet personave besueshmëria e të cilëve është përcaktuar dhe që është nën mbikqyrje nga roje, të cilët janë në komunikim të ngushtë me forcat përgjegjëse përkatëse. Masat e veçanta të marra në kontekst duhet të kenë si objekt të tyre zbulimin dhe parandalimin e ndonjë sulmi, afrimi të paautorizuar ose lëvizjen e paautorizuar të materialit.

2. Nivelet e mbrojtjes fizike për material bërthamor gjatë transportit ndërkombëtar përfshijnë:

a) për materialet e kategorisë II dhe III, transportimi duhet të kryhet në masa paraprake të veçanta që përfshijnë rregullime (masa parapake) të mëparshme midis dërguesit, marrësit dhe transportuesit dhe marrëveshje paraprake midis personave fizikë ose juridikë që iu nënshtrohen juridiksionit dhe rregullave të shteteve eksportuese dhe importuese, duke specializuar kohën, vendin dhe procedurat për transferimin e përgjegjësive të transportit;

b) për materialet e kategorisë I, transportimi duhet të kryhet nën masa paraprake speciale (të veçanta) të identifikuar më sipër për transportimin e këtyre, nën mbikqyrjen të vazhdueshme me eskorta dhe sipas kushteve që sigurojnë komunikim të ngushtë me forcat përgjegjëse përkatëse;

c) për uranium natyral të ndryshëm nga ai në formën e xeherorit (mineralit) ose mbeturinave të mineralit, mbrojtja gjatë transportimit për sasira që i kalojnë 500 kg uranium duhet të përfshijnë njoftimin përpara dërgimit, duke specifikuar mënyrën e transportit, kohën e pritshme e të mbërritjes dhe konfirmimin për marrjen e ngarkesës.

ANEKSI (SHTOJCA) II

Tabela: kategorizimi i materialit bërthamor

Materiali	Forma	Kategoria		
		I	II	III
1. Pluton (a)	Jorrezatuese	2 kg ose më shumë	Më pak se 2 kg por me shumë se 500 g	500 g ose më pak, por më shumë se 15 g
2. Uraniumi - 235	Jorrezatuese (b) - Uranium i pasuruar në 20% ose më shumë - Uranium i pasuruar në 10% U 235 por më pak se 20% - Uranium i pasuruar mbi atë natyral, por më pak se 10% U.235	5 kg ose me shumë	Më pak se 2 kg por më shumë se 500 g. 10 kg ose më shumë	500 g ose më pak, por më shumë se 15 g. më pak se 10 kg por më shumë se 1 kg  10 kg ose më shumë
3. Uraniumi - 233	Jorrezatues (b)	2 kg ose më shumë	Më pak se 2 kg por më shumë se 500 g	500 g ose më pak por më shumë se 15 g
3. Lëndë djegëse rezatuese (bërthamore)			Uraniumi i varfëruar ose natyral ose lëndë djegëse pak e pasqyruar (më pak se 10% përmbajtje fosilesh) (d), (e)	

a) Të gjitha plutonet, përveç atij me përqendrim izotopik që kalon 80% në pluton - 238.

b) Material jo i rrezatuar në një reaktor ose material i rrezatuar në reaktor, por një nivel rrezatimi i barabartë me ose më pak se 100 rads për orë në një metër të pambrojtur.

c) Sasia që nuk futet në kategorinë III dhe uraniumi natyral duhet të mbrohen në përputhje me një praktikë menaxhimi të matur.

d) Megjithëse ky nivel mbrojtjeje rekomandohet, ai duhet të jetë i hapur për shtetet mbi vlerësimin e rrethanave specifike të caktohet një kategori e ndryshme e mbrojtjes fizike.

e) Lëndë tjetër djegëse, e cila në sajë të përmbajtjes së saj fillestare acide klasifikohet si kategoria I dhe II para rrezatimit mund të ulet një shkallë kategorie kur niveli i rrezatimit nga lëndë djegëse i kalon 100 rad në orë në një metër të pambrojtur.

**LIGJ**  
**Nr. 8854, datë 31.1.2002**

**PËR RATIFIKIMIN E "PROTOKOLLIT TË BISEDIMEVE NDËRMJET QEVERISË SË  
REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË  
GJERMANISË PËR BASHKËPUNIMIN FINANCIAR DHE TEKNIK PËR VITIN 2001".**

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1, 83 pika 1 Dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave

**K U V E N D I**

**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË  
V E N D O S I:**

Neni 1

Ratifikohet "Protokolli i bisedimeve ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunimin financiar dhe teknik për vitin 2001".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.3251, datë 2.2.2002 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Rexhep Meidani**

**PROTOKOLL**

**I BISEDIMEVE MBI BASHKËPUNIMIN FINANCIAR DHE TEKNIK NDËRMJET  
QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE  
TË GJERMANISË PËR VITIN 2001**

Në datat 4 deri 5 dhjetor 2001 u zhvilluan në Tiranë Bisedimet Qeveritare mbi Bashkëpunimin Financiar dhe Teknik për vitin 2001 midis delegacionit të Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë dhe delegacionit të Qeverisë së Republikës Shqiptare.

Për delegacionin shqiptar, bisedimet u drejtuan nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Bashkëpunimit Ekonomik dhe Tregtisë, zoti Andi Nano. Delegacioni gjerman drejtohej nga zoti Dr.Leo Kreuz, Shef Seksioni në Ministrinë Federale për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim.

Lista e pjesëmarrësve të dy delegacioneve ndodhet bashkëngjitur në shtojcë.

Bisedimet u zhvilluan në një atmosferë të hapur dhe konstruktive dhe u karakterizuan nga një mirëkuptim reciprok.

Zoti Nano deklaroi hapjen e bisedimeve ndërqeveritare, duke i uruar mirëseardhjen delegacionit të Qeverisë Federale Gjermane. Ai falenderoi Palën Gjermane për kontributin e çmuar që Republika Federale e Gjermanisë i ka dhënë Republikës së Shqipërisë për zhvillim ekonomik dhe social të vendit. Zoti Nano vlerësoi lart bashkëpunimin e deritanishëm me Gjermaninë, si në aspektin financiar, ashtu dhe në atë teknik. Gjermania është ndër partnerët kryesorë të Shqipërisë, prandaj Pala Shqiptare i jep rëndësi të madhe bisedimeve të tanishme si një aktivitet i rëndësishëm në kuadër të bashkëpunimit për zhvillim të vendit.

Dr.Kreuz nënvizoi bashkëpunimin e gjithanshëm dhe të mirë të deritanishëm. Duke vlerësuar arritjet e deritanishme, ai tërhoqi vëmendjen për rëndësinë e stabilitetit të qeverisë, si kusht i nevojshëm për partneritet të besueshëm.

Kjo marrëveshje tregon interesin e madh të të dy Palëve për një bashkëpunim sa më të frytshëm. Qeveria Gjermane është një nga partnerët kryesorë të Qeverisë Shqiptare në marrëdhëniet me institucionet financiare ndërkombëtare si p.sh. Banka Botërore. Në këtë aspekt, ajo përshëndet edhe hartimin e strategjisë së luftës kundër varfërisë dhe për zhvillimin ekonomik e social të vendit, në bazë të së cilës do të ndërtohet edhe bashkëpunimi i ardhshëm dypalësh. Një aspekt i rëndësishëm është edhe mbështetja që i jepet Republikës së Shqipërisë për afrimin me strukturat europiane.

Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë mbështet fuqimisht realizimin e objektivave të Zhvillimit Ndërkombëtar të Rezolutës së miratuar në mbledhjen e përgjithshme të Kombeve të Bashkuara për përgjysmimin e varfërisë ekstreme në të gjithë botën deri në vitin 2015. Në një program aksioni, ajo ka skicuar kontributin gjerman për arritjen e këtij qëllimi dhe është zotuar të drejtojë bashkëpunimin gjerman për zhvillim në qëllim të luftës ndaj varfërisë. Qeveria partnere, Republika e Shqipërisë përpiket që nëpërmjet dekretimit dhe zbatimit të efektshëm të Strategjisë së Zhvillimit Ekonomik dhe Social të japë një kontribut të rëndësishëm në kuadrin e Program Aksionit 2015 për një politikë për reduktimin e varfërisë. Qeveria Federale e Gjermanisë do të japë mbështetjen e saj në kuadrin e bashkëpunimit për zhvillim.

Të dyja Palët përkrahin fuqimisht fushat e rëndësishme të bashkëpunimit:

Furnizimi me ujë dhe kanalizimet, energjitika, reforma ekonomike, ngritja e ekonomisë së tregut, të cilat, nëpërmjet ndikimit të tyre në grupet e varfëra të popullsisë, do të japin një kontribut të veçantë në politikën e luftës kundër varfërisë në kuadrin e Program-Aksionit 2015 të Qeverisë Federale Gjermane.

Kryetari i delegacionit gjerman shpjegoi që, në kuadrin e buxhetit federal të vitit 2001, megjithë situatën e rënduar buxhetore të Ministrisë Federale të Bashkëpunimit Ekonomik dhe Zhvillimit, për akordime të reja në bashkëpunimin financiar dhe teknik do të akordohet një shumë prej 46.81 milion DM (ose 23.93 milion Euro)

Delegacioni gjerman theksoi rëndësinë e veçantë që Qeveria Federale Gjermane i jep rregullimit të borxheve tregtare të riskeduluara të vlerësuara në masën 2.4 milion DM, të cilat janë të garantuara nga ajo. Ai përshëndeti nënshkrimin e marrëveshjes bilaterale "Shqipëria III" në datën 30 nëntor 2001 dhe qartësoi se realizimi i akordimeve të reja të bashkëpunimit financiar të bëra në këto bisedime mund të bëhet vetëm pas shlyerjes së kështit të parë, që duhej të ishte paguar në 30 qershor 2001.

#### 1. Bashkëpunimi financiar

##### Bashkëpunimi në vazhdim

Pala Shqiptare merr përsipër në bashkëpunimin e mëtejshëm që të tregojë qartë përpara fillimit të çdo projekti mënyrën e shlyerjes së detyrimeve doganore dhe taksave.

Pala Gjermane vuri në dukje problemet e mëposhtme në kuadrin e bashkëpunimit financiar:

##### 1.1.1. Politika në sektorin e furnizimit me ujë dhe kanalizime

Pala Gjermane përshëndeti ecurinë në fushën e furnizimit me ujë dhe kanalizime. Për t'u theksuar, në mënyrë të veçantë, është interesimi i Qeverisë Shqiptare për të mbështetur pjesëmarrjen e industrisë private në këtë sektor, si dhe transformimin e realizuar apo të filluar të institucioneve shtetërore të furnizimit në ndërmarrje autonome tregtare. Ajo theksoi rëndësinë e zbatimit të politikave të decentralizimit, të cilat do të kontribuojnë në zgjidhjen e pikave kritike ekzistuese për zbatimin e projektit:

- emërimi i përfaqësuesve me shumicë lokale për këshillat mbikqyrës të ndërmarrjeve të reja, të cilat nuk duhet t'i përkasin vetëm administratës publike;

- realizimi i shpejtë i procesit të kalimit të të drejtave të pronësisë të Republikës së Shqipërisë për këto ndërmarrje në pushtetin vendor;

- rregullimi i borxhit të vjetër të krijuar nga ndërmarrjet para transformimit të tyre dhe që rrezikon mbijetesën ekonomike të ndërmarrjeve të reja; Vendimi për këtë do të merret rast pas rasti.

- përcaktimi i kompetencave kombëtare, rajonale dhe lokale për rregullimin e sektorit në kuadrin e politikës së decentralizimit dhe veçanërisht forcimi i institucioneve autonome rregulluese si organe kontrolli dhe drejtuese.

Pala Gjermane theksoi se zvarritja e zgjidhjeve do të ketë pasoja negative për bashkëpunimin në këtë sektor. Pala Shqiptare siguron që në muajt e ardhshëm do të ndjekë në mënyrë intensive këto aspekte.

#### 1.1.2. Furnizimi me ujë, Elbasan

(Përkrahje ekonomike nëpërmjet zgjerimit të infrastrukturës komunale)

Nga Pala Gjermane u theksua njohja për mobilizimin e kapitalit suplementar privat për sistemet shqiptare të furnizimit (Elbasan) (shih nr.1.1.1). Ndikimet sinjalizuese të këtij projekti, të cilat janë të një rëndësie shumë të madhe për të gjithë sektorin e ujësjellësave dhe kanalizimeve të Shqipërisë, veçanërisht për tenderimin e kontratës së menaxhimit për Kavajën (shih nr.1.1.3) dhe për një koncesion tjetër për furnizimin me ujë të qyteteve Berat dhe Kuçovë, mund të shfrytëzohen vetëm nëse kontrata e koncesionit do të zbatohet menjëherë. Pala Gjermane theksoi domosdoshmërinë e plotësimit të menjëhershëm të kushteve parakontratale (Conditions Precedent) në mënyrë që zbatimi i projektit të fillojë në janar 2002.

#### 1.1.3 Furnizimi me ujë dhe kanalizimet në Kavajë

Të dyja Palët ranë dakort për të përfunduar sa më shpejt procesin e akordimit të jashtëm të kontratës së menaxhimit. Pala Shqiptare dhe Gjermane ranë dakort që, për financimin e kontratës së menaxhimit, si masa shoqëruese për projektet investuese që janë në zbatim ose të parashikuara, të përdoren fondet e Programit të Planifikimit Familjar II (3.0 milion DM akordim i vitit 1998).

Për projektin plotësues, rezervuari i Mankurisë/Kavajë, i cili për momentin është në fazën e planifikimit, Pala Shqiptare ka siguruar vënien në dispozicion të një fondi financiar në masën 1.0 milion DM, si dhe lirin nga borxhet e vjetra të Ndërmarrjes së Ujësllësit. Veç kësaj, Pala Gjermane dhe Shqiptare ranë dakord që vlera e mbetur prej 1.5 milion DM, që nevojitet për financimin e plotë të projektit, të vihet në dispozicion nga fonde të miratuara më parë.

#### 1.1.4. Politika në sektorin e furnizimit me energji elektrike

Pala Gjermane theksoi se janë të nevojshme reforma të tjera institucionale për KESH-in, që është ndërmarrja e vetme përgjegjëse për furnizimin me energji. Për t'u theksuar, në mënyrë të veçantë, janë marrëveshjet e arritura në planin e veprimit strategjik për një ndarje funksionale të prodhimit, të transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike. U përsëritet krijimi i Njësisë Menaxhimit Rajonal, pjesërisht autonome për rajonin që përfshin Projekti i Bashkëpunimit Financiar "Furnizimi me energji elektrike i Shqipërisë së Jugut", si dhe fillimi i zbatimit të këtij Projekti.

Dy Palët theksuan se ndërtimi i linjës së planifikuar 400 kv të transmetimit midis Shqipërisë (Elbasan) dhe Malit të Zi (Podgoricë) është me rëndësi të madhe rajonale dhe ndërkombëtare dhe mund të kontribuojë për kapërcimin e krizës dimërore të përsëritur të energjisë. Gjithsesi duhet që deri në vitin 2005 efienca të rritet mbi 85%, si dhe të rriten tarifat në 5 Eurocent/kwh me qëllim që projekti të ketë në të ardhmen një bazë të mjaftueshme ekonomike për investimet.

Delegacioni gjerman shpreson se Qeveria Shqiptare do të vendosë për pjesëmarrjen e ekonomisë private në sektorin e furnizimit me energji elektrike, ashtu si dhe në sektorin e furnizimit me ujë.

Pala Shqiptare konfirmoi edhe një herë premtimin e saj që, së bashku me KESH-in, të reduktojë humbjen e energjisë në nivelet e njohura të standardeve ndërkombëtare, si dhe të përmirësojë më tej pagesën e faturave.

#### 1.1.5. Ndihmë në mallra për sektorin e bujqësisë I- (Investim dhe masa shoqëruese)

Nga ndihma në mallra për sektorin e bujqësisë I nuk është paguar dhe as nuk është rezervuar një fond prej rreth 424 000 DM për lëvrim mallrash apo shërbimesh. Të dyja palët kanë rënë dakord që ta shfrytëzojnë këtë vlerë në kuadrin e masave të projektit "Infrastruktura sociale II" si shtesë e vlerës prej 4.0 milion DM. KfW-ja, në bashkëpunim me Ministrinë e Bashkëpunimit Ekonomik dhe Tregtisë, u ngarkua të riprogramojë shumën dhe të përcaktojë përdorimin e ri të saj.

#### 1.1.6. Fondet e investimeve sociale (FSHZH)

Pala Gjermane i kushtoi rëndësi faktit që shumica e përbërjes aktuale të këshillit mbikqyrës të FSHZH-së i përket përfaqësuesve të qeverisë qendrore, në kundërshtim me kërkesat e grupeve të orientuara pjesëmarrëse të fondit. U këshillua në mënyrë të menjëhershme që përbërja të ndryshojë në favor të një pjesëmarrjeje më të madhe të përfaqësuesve lokalë dhe jo përfaqësuesve të atij publik.

## 1.2. Premtime të reja

Të dy delegacionet ranë dakord që, me mjetet e bashkëpunimit financiar të vitit 2001 prej gjithsej 37.0 milion DM, të merret në konsideratë zbatimi i projekteve të mëposhtme:

1.2.1 "Furnizimi me ujë dhe kanalizimi i ujërave të zeza, Korçë II" 13.0 milion DM (Kontribut financiar)

1.2.2 "Furnizimi me ujë dhe kanlizimi i ujërave të zeza, Krujë II" 5.0 milion DM (Kontribut financiar)

1.2.3 "Fondi i investimeve sociale III (FSHZH)" 4.5 milion DM

Investime në Shqipërinë e Veriut (Kredi)

1.2.4. "Fondi i investimeve sociale III në veri të Shqipërisë" 0.5 milion DM

Masa shoqëruese (Kontribut financiar)

1.2.5 "Fonde studimi dhe ekspertësh" 2.0 milion DM

(Kontribut financiar)

1.2.6 "Biorezervati ndërkuftar i Prespës" 5.0 milion DM

(Kontribut financiar)

1.2.7 Linja 400 KV Elbasan-Podgoricë (investim shtesë) 7.0 milion DM

(Kredi)

## 1.3. Riprogramimi

Nga 1997 Planifikim familjar II 3.0 milion DM në

favor të "Ndërtimit dhe organizimit të kapacitetit menaxhues të Ndërmarrjes Ujësjellës-Kanalizime në Kavajë"

- Masa shoqëruese -3.0 milion DM

(Kontribut financiar)

Nga 1998 FEFAD III në favor të "Furnizimit me

ujë, Kavajë" 1.5 milion DM

(Kredi)

Nga sektori i përcaktuar ndihmë në mallra në Bujqësi I

në favor të Fondit të Investimeve Sociale II, (FSHZH) 0.424 milion DM

## 1.4. Bashkëpunimi i ardhshëm

Në kuadrin e konsultimeve qeveritare në maj të këtij viti si fusha të rëndësishme të bashkëpunimit për të cilat u ra dakord ishin:

1. Furnizimi me ujë dhe kanalizime; 2. Energjitika; 3. Reformat ekonomike/Ndërtimi i ekonomisë së tregut.

Të dy Palët ranë dakord që bashkëpunimi të vazhdojë sipas programeve të mëposhtme:

1.4.1. Vazhdimi i angazhimit në sektorin e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve në zonat ku KfW ushtron veprimtarinë me projekte të furnizimit me ujë dhe kanalizime me masat plotësuese në fushën e përpunimit të mbeturinave. Këtu është parashikuar, së pari, për qytetet Pogradec dhe Korçë që në kuadrin e fondeve të studimeve dhe ekspertëve të kryhet një studim përgatitor, i cili do të përmbajë edhe masat e ndihmës së menjëhershme.

1.4.2 Mbrojtja e mjedisit në Shkodër/Liqeni i Shkodrës: Nga Pala Shqiptare është deklaruar si prioritet kombëtar mbrojtja e liqenit të Shkodrës dhe kjo duhet të mbështetet nëpërmjet investimeve në sistemet e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve të qytetit të Shkodrës.

1.4.3. Një projekt tjetër për "Furnizimin me ujë të zonave rurale" (parashikohet për veriun e Shqipërisë)

1.4.4. Shtesa të mëtejshme financiare për projektin e linjës së transmetimit 400 kv (Elbasan (Shqipëri) - Podgoricë (Mal i Zi), përfshirë edhe nënstationin elektrik në Tiranë.

1.4.5 Në kuadrin e Energjitikës" Projekti i "Rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike në Korçë"

## 2. Bashkëpunimi teknik

Bashkëpunimi në vazhdim

Të dyja Palët shprehën kënaqësinë e tyre për zbatimin e projekteve në vazhdim.

Në të ardhmen, bashkëpunimi teknik do të mbështesë më shumë përpjekjet e Shqipërisë për përafrimin në strukturat evropiane dhe do të ndihmojë në përmirësimin hap pas hapi të kushteve të jetesës drejt standardeve evropiane. Në këtë kuadër, projektet e mëposhtme do t'i përshtaten këtij qëllimi:

## 2.2. Akordime të reja

Volumi i përgjithshëm i bashkëpunimit teknik me Republikën e Shqipërisë, deri në fund të vitit 2000, arrin një shifër prej rreth 122,5 milion DM (baraz me 62,5 milion Euro). Për vitin 2001 Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë do t'i akordojë Qeverisë së Republikës së Shqipërisë një shumë prej 5.31 milion DM për zbatimin e projekteve të bashkëpunimit teknik.

## 2.3. Fonde rezervë

Me shkresën e datës 7 qershor 2001 Qeveria Shqiptare, referuar pikës 3.2 të Minutave të Takimit të Konsultimeve të datës 17 Maj 2001, ka bërë kërkesën që fondet e mbetura (0.81 milion DM) nga Projekti "Miniera e kromit në Bulqizë" për shkak të përfundimit të parakohshëm të tij të kalojnë si shtesë fondesh për projektin "Modernizimi i shërbimeve komunale në disa qytete të përzgjedhura të Shqipërisë. Këtu do të përfshihej, në mënyrë të veçantë, qendra e zonës veriore të vendit, qyteti i Shkodrës. Delegacioni gjerman e miratoi këtë dëshirë. Meqenëse fondet e mbetura të projektit të vjetër të 1988 e të përfunduar para kohe nuk mund të vihen në dispozicion për arsye të buxhetit, këto u zëvendësuan me fonde të reja të rezervave të vitit 2001.

## 2.4 Përdorimi i fondeve

Të dy qeveritë ranë dakord që të përdoren akordimet (pika 2.2) dhe fondet rezervë (pika 2.3) për projektet e mëposhme:

### 2.4.1 "Modernizimi i shërbimeve komunale në disa qytete të përzgjedhura të Shqipërisë"

-Shtesë fondesh 2.01 milion DM

Kontributi përbëhet nga 1.2 milion DM të Fondit të bashkëpunimit teknik dhe nga riprogramimi (pika 2.3) në masën 0.81 milion DM.

### 2.4.2 "Reforma e praktikës ligjore"

- Shtesë fondesh, projekt në zbatim 0.5 milion DM

2.4.3 "Modernizimi i ekonomisë agrare shqiptare" (Përafrimi me BE-në dhe konsolidimi i projekteve aktuale të bujqësisë - shtesë fondesh, projekt në zbatim.

2.0 milion DM

### 2.4.4 "'Fondi studime dhe eksperte"- Shtesë fondesh 0.8 milion DM

Të dyja Palët ranë dakord që nga ky fond të financohen projektet e mëposhtme:

- këshillim dhe mbështetje profesionale për bashkëpunimin teknik bilateral;
- shkëmbim eksperience i manaxherëve shqiptarë me ekonominë gjermane dhe forcimi i shoqatave të sipërmarrësve shqiptarë;
- këshillim profesional për zhvillimin e rregullave të ndërtimit për masat mbrojtëse nga tërmetet, masat e kursimit të energjisë dhe për ndalimin e zënies së parregullt të sipërfaqeve;
- vazhdimi i shkëmbimit profesional mbi zhvillimin e turizmit.

## 2.5 Bashkëpunimi i ardhshëm

Të dy delegacionet ranë dakord për të marrë në shqyrtim fushat e mëposhtme të këshillimit dhe mbështetjes për bashkëpunimin e ardhshëm:

- këshillim në futjen e nocioneve të reja për menaxhimin e cilësisë në ekonominë artizanale;
- mbështetje për afrimin me Bashkimin Europian/mbështetje për procesin e stabilizimit dhe asocimit;
- iniciativa e mbrojtjes së konsumatorëve;
- Pala Shqiptare propozoi që në bashkëpunimin e mëtejshëm të mbështetet një projekt modern arsimimi profesional në shërbim të zhvillimit të ekonomisë së tregut.

## 3.Format e tjera të bashkëpunimit teknik

### 3.1 Ekspertët e integruar

Delegacioni gjerman theksoi se Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë mund të mbështesë Republikën e Shqipërisë nëpërmjet vënies në dispozicion të ekspertëve të integruar.

Kusht është që këta ekspertë të hyjnë në marrëdhënie pune me organizmat publike dhe private në Shqipëri, Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë është e gatshme t'u garantojë atyre një kompensim pagese në kuadrin e mundësive të saj buxhetore. Kërkesat për ekspertët e integruar nga institucionet publike dhe private shqiptare duhet t'i drejtohen Ambasadës Gjermane në Tiranë, Qendrës "Centrum für Internationale Migration und Entwicklung (CIM)", Barckhausstr. 16, D-60325 Frankfurt an Main.

### 3.2. Formimi politiko-shoqëror

Delegacioni gjerman vuri në dukje që në Shqipëri, me mbështetjen financiare të Qeverisë Gjermane, vazhdon të veprojë një fondacion politik i Republikës Federale të Gjermanisë, Fondacioni Hanns Seidel. Përveç kësaj, Instituti për Bashkëpunim Ndërkombëtar i Shoqërisë së Shkollave Popullore zbaton masa mbështetëse për arsimimin e të rriturve.

### 3.3 Puna e institucioneve fetare

Kryetari i delegacionit gjerman informoi që Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë mbështet financiarisht edhe punën e institucioneve fetare gjermane në Shqipëri në kuadrin e bashkëpunimit për zhvillim.

### 3.4 Konsulencë nga shoqata "Senior Expert Service" (SES)

Pala Gjermane informoi mbi veprimtarinë e SES-it, të mbështetur nga Qeveria Federale Gjermane. Thelbi i këshillimit nga ekspertët në pension të kësaj organizate është zgjidhja e problemeve akute teknike ose ekonomike në firmat e vogla dhe të mesme të biznesit.

### 4. Kushte për zbatimin e projekteve

Të dy delegacionet ranë dakord që të gjitha kontributet e Palës Gjermane të paraqitura në këtë protokoll (në pikat 1 dhe 2) mund të zbatohen vetëm pasi:

- Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë të ketë marrë një vendim pozitiv pas shqyrtimit të projekteve ato të programeve nga Kreditanstalt für Wiederaufbau (KfW) (Banka për Rindërtim), Deutsche Gesellschaft für Technische Zusammenarbeit (GTZ) (Shoqëria Gjermane për Bashkëpunim Teknik) dhe/apo një organizatë tjetër e ngarkuar me zbatimin e tyre;
- të jetë siguruar financimi i përgjithshëm i projektit/programit;
- të kenë hyrë në fuqi marrëveshjet ndërkombëtare që janë akoma në shqyrtim (marrëveshje qeveritare dhe marrëveshje projekti), si dhe marrëveshjet e financimit, të kredisë dhe të zbatimit me KfW-në, GTZ-në dhe, sipas rastit, me organizatat e tjera zbatuese.

### 5. Klauzolë rezervë

- Pala Gjermane vuri në dukje se akordimet e bashkëpunimit financiar (pika 1) dhe të bashkëpunimit teknik (pika 2) shfuqizohen pa zëvendësim, në rast se marrëveshjet e zbatimit (d.m.th. përkatësisht marrëveshjet e kredisë apo të financimit për bashkëpunimin financiar dhe zakonisht shkëmbimi i notave për bashkëpunimin teknik) nuk lidhen brenda 8 viteve pas vitit të akordimit. Për akordimet e vitit 2001 afati mbaron më 31 dhjetor 2009.

- Në rast se një apo disa projekte të përmendura nuk zbatohen apo zbatohen vetëm pjesërisht, ato mund të zëvendësohen me një projekt tjetër apo me projekte të tjera, nëse të dy qeveritë bien dakord për këtë.

## DEKLARATË

- Pala Gjermane përshëndeti masat e marra nga Qeveria Shqiptare për luftën kundër korrupsionit. Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria Federale Gjermane shprehën të njëjtin vlerësim se korrupsioni dëmton qeverisjen e mirë, shpërdor fondet financiare dhe ka pasoja të thella negative për zhvillimin ekonomik dhe atë social të vendit.

Ai rrezikon besueshmërinë e bashkëpunimit për zhvillim, mbështetjen e tij nga publiku dhe frenon përpjekjet e të gjithëve që angazhohen për të mbështetur zhvillimin afatgjatë, si dhe pengon konkurrencën e hapur dhe transparente, ndër të tjera edhe lidhur me çmimet dhe me cilësinë.

Të dy qeveritë do të punojnë ngushtë me njëra-tjetrën për të siguruar transparencë, dhënie llogarie dhe integritet gjatë përdorimit të fondeve publike dhe për të shmangur raste të mundshme ekzistuese të praktikave të korruptuara në bashkëpunimin për zhvillim.

Të dy delegacionet ranë dakord që konsultimet e ardhshme të zhvillohen në Tiranë dhe që bisedimet qeveritare të zhvillohen në Tiranë në vitin 2002. Për afatet kohore do të bihet më vonë dakort.

Ky protokoll u hartua në gjuhën shqipe dhe në gjuhën gjermane.

Ky protokoll hyn në fuqi pas njoftimit me notë verbale të Palës Shqiptare drejtuar Palës Gjermane mbi përfundimin e procedurave ligjore të miratimit të tij.

Për delegacionin e Qeverisë së Republikës  
Federale të Gjermanisë

Dr.Leo Kreuz

Për delegacionin e Qeverisë së Republikës së  
Shqipërisë

Prof.Dr.Ermelinda Meksi

## LIGJ

Nr. 8855, datë 31.1.2002

### **PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË PËR SHTYRJEN E PAGESAVE TË BORXHIT” (MARRËVESHJA “SHQIPËRIA III”)**

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

## **K U V E N D I**

### **I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË V E N D O S I:**

#### Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për shtyrjen e pagesave të borxhit” (Marrëveshja “Shqipëria III”).

#### Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.3252, datë 2.2.2002 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani**

## **MARRËVESHJE**

**NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS  
FEDERALE TË GJERMANISË MBI SHTYRJEN E PAGESAVE TË REPUBLIKËS SË  
SHQIPËRISË**

(Shqipëria III)

Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë:

Mbi bazën e Termave të Referencës, të përcaktuara nga vendet kreditore të Klubit të Parisit për shtyrjen e pagesave të Republikës së Shqipërisë (“Termat e Referencës”), dhe në vazhdim të korrespondencës lidhur me këtë shtyrje pagesash ndërmjet Presidentit të Klubit të Parisit dhe Ministrisë të Financave të Republikës së Shqipërisë më 14 tetor 1999 dhe 18 janar 2000

bien dakord si më poshtë:

#### Neni 1

### **Shtyrja e pagesave për detyrimet që rrjedhin nga Marrëveshja “Shqipëria I”**

(1) Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë do t'i lejojë Qeverisë së Republikës të Shqipërisë, në bazë të dispozitave të kësaj Marrëveshjeje, të bëjë një shtyrje të pagesës së principave dhe interesave që rrjedhin nga Marrëveshja për riskedulimin e borxhit të jashtëm të Republikës së Shqipërisë, përfunduar ndërmjet dy Qeverive më 7 korrik 1994 (Marrëveshja “Shqipëria 1”). Këtu përfshihen ato detyrime të lindura nga veprimet tregtare, që duheshin paguar në periudhën ndërmjet 1 prill 1999-30 qershor 2000 dhe që nuk janë paguar.

(2) Gjithashtu, Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë, në bazë të dispozitave të kësaj Marrëveshjeje, do të bëjë një shtyrje të pagesës së principave dhe të interesave që rrjedhin nga Marrëveshja “Shqipëria I” për veprimet e kryera në rubla-klering, të përcaktuara në nenin 3 të Marrëveshjes “Shqipëria I”, detyrime këto që duheshin paguar në periudhën ndërmjet 1 prill 1999-30 qershor 2000 dhe që nuk janë paguar.

#### Neni 2

### **Shtyrja e pagesave për detyrimet që rrjedhin nga bashkëpunimi financiar**

(1) Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë, në bazë të dispozitave të kësaj Marrëveshjeje, do t'i lejojë Qeverisë së Republikës të Shqipërisë një shtyrje të pagesave për:

(a) detyrimet që rrjedhin nga kontrata me kohëzgjatje fillestare më shumë se një vit dhe të nënshkruara përpara 30 shtatorit 1993 me Kreditanstalt fur Wiederaufbau, në bazë të bashkëpunimit financiar;

(b) detyrimet që rrjedhin nga kontrata me kohëzgjatje fillestare më shumë se një vit dhe të nënshkruara ndërmjet 30 shtatorit 1993 dhe 1 prillit 1999 me Kreditanstalt fur Wiederaufbau, në bazë të bashkëpunimit financiar.

Këtu përfshihen ato detyrime që duheshin paguar në periudhën ndërmjet 1 prill 1999 dhe 30 qershor 2000 dhe që nuk janë paguar.

(2) Detyrimet për të cilat bëhet fjalë në paragrafin 1b përjashtohen nga ndonjë riskedulim tjetër.

(3) Shtyrja e pagesave në përputhje me paragrafin 1 më lart do të zbatohet për të gjitha huatë që i janë dhënë Republikës së Shqipërisë apo që janë garantuar prej saj ose prej institucioneve të saj përkatëse.

#### Neni 3

### **Efektet në kontratat origjinale dhe në Marrëveshjen “Shqipëria I”**

Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë do të sigurojë që kreditorët gjermanë nuk do t'i kërkojnë debitorëve shqiptarë detyrimet e përfshira në këtë Marrëveshje për gjithë kohën e zgjatjes së kësaj Marrëveshjeje. Me fjalë të tjera, kontratat origjinale dhe Marrëveshja “Shqipëria I” do të preken nga kjo Marrëveshje dhe nga masat që do të merren në zbatim të saj, vetëm për atë sa është përcaktuar në dispozitat e kësaj Marrëveshjeje.

#### Neni 4

### **Detyrimet që rrjedhin nga veprimet tregtare**

Shuma e detyrimeve të përcaktuara në nenin 1 paragrafi 1 nuk do t'i kalojë 2,401,802.29 DM (dy milion e katërqind e një mijë e tetëqind e dy pikë njëzet e nëntë). Kjo shumë është e barabartë me 1,228,022.02 EUR (një milion e dyqind e njëzet e tetë mijë e njëzet e dy pikë zero dy). Kjo shumë në DM dhe në euro, si edhe shumat në DM, të rëna dakord për çdo transaksion të veçantë, janë dhënë në Aneksin 1 të kësaj Marrëveshjeje.

#### Neni 5

### **Detyrimet që rrjedhin nga veprimet në rubla-klering**

Shuma e detyrimeve të përcaktuara në nenin 1 paragrafi 2 është 1,743,625.00 DM (një milion e shtatëqind e dyzet e tre mijë e gjashtëqind e njëzet e pesë pikë zero zero). Kjo shumë është e barabartë me 891,501.31 EUR (tetëqind e nëntëdhjetë e një mijë e pesëqind e një pikë e tridhjetë e një). Kjo shumë, në DM dhe në euro, si edhe shumat në DM, të rëna dakord për çdo transaksion të veçantë, janë dhënë në Aneksin 2 të kësaj Marrëveshjeje.

#### Neni 6

### **Detyrimet që rrjedhin nga bashkëpunimi financiar**

(1) Shuma e detyrimeve të përcaktuar në nenin 2 paragrafi 1a është 254,584.32 DM (dyqind e pesëdhjetë e katër mijë e pesëqind e tetëdhjetë e katër pikë tridhjetë e dy). Kjo shumë është e barabartë me 130,166.90 EUR (njëqind e tridhjetë mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë pikë nëntëdhjetë). Kjo shumë, në DM, dhe në euro, si edhe shumat në DM të rëna dakord për çdo transaksion të veçantë, janë dhënë në Aneksin 3 a të kësaj Marrëveshjeje.

(2) Shuma e detyrimeve të përcaktuara në nenin 2 paragrafi 1b është 229,720.81 DM (dyqind e njëzet e nëntë mijë e shtatëqind e njëzetë pikë e tetëdhjetë e një). Kjo shumë është e barabartë me 117,454.39 EUR (njëqind e shtatëmbëdhjetë mijë e katërqind e pesëdhjetë e katër pikë tridhjetë e nëntë). Kjo shumë, në DM dhe në euro, si edhe shumat në DM, të rëna dakord për çdo transaksion të veçantë, janë dhënë në Aneksin 3b të kësaj Marrëveshjeje.

#### Neni 7

### **Kursi i këmbimit**

Kursi i këmbimit nga DM në euro do të jetë ai i fiksuar nga Këshilli i Bashkimit Europian më 31 dhjetor 1998. Një euro është e barabartë me 1.95583 DM. ( një pikë nëntë pesë pesë tetë tre).

#### Neni 8

### **Ripagimi**

Qeveria e Republikës së Shqipërisë do të paguajë shumat për të cilat bëhet fjalë në nenet 4, 5 dhe 6, në dhjetë këste të barabarta dhe të njëpasnjëshme gjashtëmujore i pari fillon më 30 qershor 2001 dhe i fundit më 31 dhjetor 2005.

#### Neni 9

### **Interesi**

(1) Qeveria e Republikës së Shqipërisë do të paguajë interes prej 5.7% në vit për shumat për të cilat bëhet fjalë në nenin 4.

(2) Qeveria e Republikës së Shqipërisë do të paguajë interes prej 5.7% në vit për shumat për të cilat bëhet fjalë në nenin 5.

(3) Qeveria e Republikës së Shqipërisë do të paguajë interes prej 0,75 në vit për shumat për të cilat bëhet fjalë në nenin 6.

(4) Llogaritja e interesit do të fillojë nga datat e përcaktuara në kontratat origjinale ose në Marrëveshjen "Shqipëria I". Detyrimi për të paguar interes përfundon në datën në të cilën shumat që duhen paguar janë kredituar në llogarinë bankare të marrësit sipas nenit 10 paragrafi 3, nenit 11 paragrafi 3 ose nenit 12 paragrafi 3.

(5) Interesi i akumuluar sipas kësaj Marrëveshjeje në periudhën nga 1 prilli 1999 deri më 30 qershor 2000 do të kapitalizohet më 30 qershor 2000 dhe do të paguhet në përputhje me nenin 8. Për shumat e kapitalizuara do të paguhet interes duke filluar nga 1 korriku 2000, sipas përqindjeve të zbatuara për secilin rast në përputhje me paragrafët 1, 2 ose 3 më sipër.

(6) Interesi që duhet paguar në përputhje me këtë Marrëveshje, që nga 1 korriku 2000, do të paguhet:

- për periudhën nga 1 korriku 2000 deri në dhe përfshirë 30 qershor 2001, menjëherë pas ratifikimit të Marrëveshjes nga Parlamenti Shqiptar, por jo më vonë se 15 dhjetor 2001; dhe
- paskëtaj, çdo gjashtë muaj më 30 qershor dhe 31 dhjetor të çdo viti, duke filluar nga 30 dhjetor 2001.

#### Neni 10

#### **Zbatimi lidhur me detyrimet që rrjedhin nga veprimet tregtare**

(1) Përsa i përket shumave për të cilat bëhet fjalë në nenin 4 dhe që rrjedhin nga veprimet tregtare, zbatimi i kësaj Marrëveshjeje do t'i besohet:

- nga Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë një Konsorciumi të përbërë nga HERMES Kreditversicherungs-Aktiengesellschaft, Hamburg, dhe PwC Deutsche Revision Aktiengesellschaft Wirtschaftsprüfungsgesellschaft, Frankfurt mbi Main ("Konsorciumi");
- nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë, Bankës së Shqipërisë.

(2) Konsorciumi dhe Banka e Shqipërisë do të përfundojnë, në kohën e nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje, një marrëveshje të veçantë me shkrim, lidhur me zbatimin e saj. Konsorciumi dhe Banka e Shqipërisë do të autorizohen që, me mirëkuptim të dyanshëm, të bëjnë ndryshime në shumat e dhëna në Aneksin 1 të kësaj Marrëveshjeje.

(3) Pagesat sipas kësaj Marrëveshjeje për detyrimet që rrjedhin nga veprimet tregtare, për të cilat bëhet fjalë në nenin 1 paragrafi 1, do të kryhen në euro në datën e duhur sipas kësaj Marrëveshjeje, pa bërë asnjë zbritje për taksa, gjoba apo komisione të tjera, në llogarinë bankare të Konsorciumit në Hamburg, llogari që përcaktohet në Marrëveshjen për të cilën flitet në paragrafin 2 më lart.

(4) Në qoftë se pagesat e principalit për të cilat flitet në nenin 8 për detyrimet që rrjedhin nga veprimet tregtare nuk kryhen në përputhje me datat e përcaktuara në këtë Marrëveshje, atëherë përqindja e interesit që do të zbatohet mbi shumat e papaguara sipas nenit 9 paragrafi 1 do të rritet me një për qind që nga data kur duhet kryer pagesa deri në datën kur kjo pagesë do të kryhet. Kjo rritje nuk do të zbatohet nëse vonesa në pagesë është më e vogël se 15 ditë kalendarike.

(5) Nëse interesi sipas nenit 9 paragrafi 1 nuk paguhet në datën e caktuar sipas nenit 9 paragrafi 6 ai do të kapitalizohet. Mbi shumat e papaguara të interesit, do të paguhet interes me përqindje siç përcaktohet në nenin 9 paragrafi 1, që nga data kur duhet kryer pagesa deri në datën e kryerjes së saj, me përjashtim të rasteve kur vonesa në pagesë është më e vogël se 15 ditë kalendarike.

(6) pagesat e bëra Konsorciumit do të kreditohen sipas kësaj rradhe:

- Së pari për interesin mbi shumat e papaguara të interesit, sipas paragrafit (5) më lart;
- për interesin mbi shumat e papaguara të principalit, sipas paragrafit (4) më lart;
- për shumat e papaguara të interesit, sipas paragrafit (5) më lart;
- për interesin e rregullt, sipas nenit 9 paragrafi 1 dhe 6;
- së fundi, për pagesën e principalit, sipas nenit 8.

Të gjitha pagesat do të kreditohen në përputhje me datat e parashikuara për kryerjen e tyre, duke filluar në çdo rast në datën më të parë. Në rast se, faktikisht, do të ketë pagesa më të mëdha sesa duheshin paguar, atëherë diferenca do të zbritet nga pagesa e ardhshme e principalit sipas nenit 8.

#### Neni 11

#### **Zbatimi lidhur me detyrimet që rrjedhin nga veprimet në rubla-klering**

(1) Përsa i përket detyrimeve nga veprimet në rubla-klering, për të cilat bëhet fjalë në nenin 5, zbatimi i kësaj Marrëveshjeje do t'i besohet:

- nga Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë, Kredintansfalt für Wiederaufbau;

- nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë, Bankës së Shqipërisë.

(2) Banka e Shqipërisë dhe Kreditanstalt fur Wiederaufbau do të përfundojnë, pas nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje, një marrëveshje të veçantë me shkrim lidhur me zbatimin e saj. Banka e Shqipërisë dhe Kreditanstalt fur Wiederaufbau do të autorizohen që, me mirëkuptim të dyanshëm, të bëjnë ndryshime në shumat e dhëna në Aneksin 2 të kësaj Marrëveshjeje.

(3) Pagesat sipas kësaj Marrëveshjeje për detyrimet që rrjedhin nga veprimet në rublaklering, për të cilat bëhet fjalë në nenin 1 paragrafi 2, do të kryhen pavarësisht nga përfundimi i marrëveshjes me shkrim për të cilën flitet në paragrafin 2 më lart. Këto pagesa do të kryhen në favor të Kreditanstalt fur Wiederaufbau në datat e caktuara në këtë Marrëveshje, pa bërë asnjë zbritje për taksa, gjoba apo komisione të tjera.

(4) Të gjitha provizionet e nenit 10, paragrafët nga 4 në 6 do të zbatohen edhe në këtë rast.

#### Neni 12

#### **Zbatimi lidhur me detyrimet që rrjedhin nga bashkëpunimi financiar**

(1) Kushtet për shtyrjen e pagesave të detyrimeve që rrjedhin nga bashkëpunimi financiar, për të cilat flitet në nenin 6, do të përcaktohen në një marrëveshje konsolidimi ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Kreditanstalt fur Wiederaufbau. Marrëveshja e konsolidimit do të jetë subjekt i ligjit të Republikës Federale të Gjermanisë. Qeveria e Republikës së Shqipërisë do të përjashtojë Kreditanstalt fur Wiederaufbau-n nga çdo taksë apo komision tjetër që mund të vendoset në Republikën e Shqipërisë gjatë përfundimit ose zbatimit të marrëveshjes së konsolidimit.

(2) Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe Kreditanstalt fur Wiederaufbau do të autorizohen që, me mirëkuptim të dyanshëm, të bëjnë ndryshime në shumat e dhëna në Aneksin 3a dhe 3b të kësaj Marrëveshjeje.

(3) Pagesat sipas kësaj Marrëveshjeje për detyrimet që rrjedhin nga bashkëpunimi financiar, për të cilat flitet në nenin 2, do të kryhen pavarësisht nga përfundimi i marrëveshjes së konsolidimit, në favor të Kreditanstalt fur Wiederaufbau, sipas datave të përcaktuara në këtë Marrëveshje.

#### Neni 13

#### **Trajtimi i barabartë**

Në qoftë se Republika e Shqipërisë e ka bërë ose i bën një vendi të tretë një trajtim më të favorshëm për detyrime të njëjta ose të ngjashme, atëherë detyrimet për të cilat bëhet fjalë në këtë Marrëveshje do të kenë të njëjtin trajtim, pa qenë nevoja e një marrëveshjeje speciale. Kjo nuk zbatohet për përqindjet e interesit të specifikuar në këtë Marrëveshje.

#### Neni 14

#### **Kushtet**

(1) Zbatimi i kësaj Marrëveshjeje kushtëzohet nga plotësimi i kushteve të përcaktuara në Seksionin IV paragrafi 3 të Termave të Referencës. Në qoftë se këto kushte nuk plotësohen, Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë ka të drejtë të ndalojë zbatimin e kësaj Marrëveshjeje dhe të kërkojë pagesën e shumave për të cilat bëhet fjalë në nenet 4, 5 dhe 6 të saj në datat dhe sipas termave të përcaktuara në kontratat përkatëse ose në Marrëveshjen “Shqipëria I”. Shumat që duhen paguar pas përfundimit të kësaj Marrëveshjeje do të paguhet në datat e përcaktuara në kontratat origjinale.

(2) Në qoftë se ndonjë detyrim që rrjedh nga kjo Marrëveshje, në mënyrë të veçantë, nëse pagesat e parashikuara nuk janë kryer ose janë kryer pjesërisht në datat e përcaktuara në këtë Marrëveshje, atëherë të dy Palët Kontraktore do të hyjnë në konsultime me qëllim arritjen e një zgjidhjeje të përshtatshme për të dy Palët. Konsultimet do të fillojnë brenda tridhjetë ditëve kalendarike pasi Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë do t'i propozojë Qeverisë të Republikës së Shqipërisë zhvillimin e konsultimeve.

Në qoftë se konsultimet nuk fillojnë apo nëse nuk arrihet në një marrëveshje të përbashkët brenda tridhjetë ditëve kalendarike, Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë ka të drejtë të ndalojë zbatimin e kësaj Marrëveshjeje dhe të kërkojë pagesën e menjëhershme të të gjitha shumave të përfshira në këtë Marrëveshje, duke përfshirë edhe interes-vonesat.

**Neni 15**  
**Anekset**

Anekset 1 deri 3, të përmendura në nenet 4, 5 dhe 6, do të përbëjnë një pjesë integrale të kësaj Marrëveshjeje.

**Neni 16**  
**Hyrja në fuqi**

1. Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në datën në të cilën Qeveria e Republikës së Shqipërisë ka njoftuar Qeverinë e Republikës Federale të Gjermanisë se kërkesat kushtetuese kombëtare për këtë hyrje në forcë janë plotësuar. Data përkatëse do të jetë dita në të cilën njoftimi është bërë.

2. Kjo Marrëveshje do të zbatohet provizorisht pas nënshkrimit.

Bërë më 30.11.2001 në Tiranë në dy kopje në gjuhët angleze dhe gjermane, të dyja të barasvlefshme.

Për Qeverinë e  
Republikës së Shqipërisë

Për Qeverinë e  
Republikës Federale të Gjermanisë

Aneks 1 lidhur me nenin 4 të Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë mbi shtyrjen e pagave të Republikës së Shqipërisë (“Shqipëria III”)

Marrëveshja e datës	Data e maturimit	Principali në DM	Interesi në DM	Gjithsej DM
7 korrik 1994 ("Shqipëria I")	31.12.1999	1,001,314.19	116,603.04	1,001,314.19
	31.12.1999	1,201,577.03		116,603.04
	30.6.2000	1,201,577.03	82,308.03	1,201,577.03
	30.6.2000			82,308.0
		2,202,891.22	198,911.07	2,401,802.29

Gjithsej Aneksi 1: DM2,401,802.29  
EUR1,228,022.02

Aneksi 2 lidhur me nenin 5 të Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë mbi shtyrjen e pagave të Republikës së Shqipërisë (“Shqipëria III”)

Shumat në DM

Data e maturimit	Principali	Interesi	Gjithsej
31.12.1999	650,000.000	227,500.00	877,500.00
30.06.2000	650,000.000	216,125.00	866,125.00
Gjithsej	1,300,000.00	443,625.00	1,743,625.00

**DEKRET**  
**Nr. 3231, datë 22.1.2002**

**PËR LEJIM LËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92 pika "c" të Kushtetutës, të nenvë 15, 19 dhe 20 të ligjit nr.8389, datë 5.8.1998 "Për shtetësinë shqiptare", bazuar edhe në propozimin e Ministrit të Rendit Publik,

**D E K R E T O J:**

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Ferit Bajram Shabani
2. Vjollca Osman Shabani (Mema)
3. Bertan Ferit Shabani
4. Agim Demir Belshi
5. Mirela Kujtim Qyrfyci (Kaimi)
6. Maggy Ermir Qyrfyci
7. Agron Sinan Larushku
8. Ilija Xhemal Allmetaj
9. Valentin Sokrat Çani
10. Diana Thanas Çani (Gjikhuri)
11. Eni Valentin Çani
12. Arian Rasim Laci (Laçi)
13. Bejaze Mero Shehu (Shushellari)
14. Ema Ndoc Ndoja
15. Rudina Skënder Hugi (Cami)
16. Joel Bujar Hugi
17. Edmond Ali Masha
18. Leonard Teki Mamaj
19. Fateo Leonard Mamaj
20. Edinjo Leonard Mamaj
21. Anila Ramadan Mamaj (Ferzaj)
22. Qemal Abedin Sebderi
23. Bersant Bego Gaba
24. Pajtim Zubihi Dalani
25. Andi Pajtim Dalani
26. Vjollca Josif Dalani (Trushi)
27. Dallandyshe Besim Schmidt (Muça)
28. Miledi Fatmir Koleci
29. Shkëndije Idriz Fuchs (Sadikaj)

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

**PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**  
**Rexhep Meidani**

**VENDIM**  
**Nr. 15, datë 21.1.2002**

**PËR KRIJIMIN E KOMISIONIT TË POSAÇËM TË KUVENDIT PËR SHQYRTIMIN E REKOMANDIMEVE TË OSBE-SË/ODIHR-IT PËR ZGJEDHJET PARLAMENTARE TË VITIT 2001**

Për zbatimin e rekomandimeve të raportit të OSBE-së/ODIHR-it për zgjedhjet parlamentare të vitit 2001 në Shqipëri, në mbështetje të nenit 77 paragrafi i parë të Kushtetutës dhe neneve 22 e 30 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Kryetarit të Kuvendit,

**K U V E N D I**

**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**  
**V E N D O S I:**

I. Krijohet Komisioni i Posaçëm Parlamentar Bipartizan (pozitë-opozitë) për shqyrtimin e rekomandimeve në raportin përfundimtar të OSBE-së/ODIHR-it për zgjedhjet parlamentare të 24 qershorit të vitit 2001.

II. Detyrat, numri, përbërja dhe afati i veprimtarisë së këtij Komisioni caktohen me vendim të veçantë nga Kuvendi.

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**K R Y E T A R I**  
**Namik Dokle**

**VENDIM**  
**Nr. 16, datë 31.1.2002**

**PËR ZGJEDHJEN E ZËVENDËSKRYETARIT TË KUVENDIT**

Në mbështetje të neneve 75 dhe 78 të Kushtetutës dhe të nenit 8 të Rregullores së Kuvendit

**K U V E N D I**

**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**  
**V E N D O S I:**

I. Zonja Jozefina Topalli zgjidhet në detyrën e Zëvendëskryetares së Kuvendit.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**K R Y E T A R I**  
**Namik Dokle**

## NDREQJE GABIMESH

1. Në Fletoren Zyrtare nr.60, në Vendimin e KM nr.702, datë 27.12.2001  
është: Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1.1.2001  
bëhet: Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1.1.2002
2. Në Fletoren Zyrtare nr.62, në Vendimin e KM nr.711, datë 27.12.2001  
është: Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare prej 1 janarit 2001  
bëhet: Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare prej 1 janarit 2002.

Fletorja Zyrtare gjendet:

- Në çdo njësi postare të çdo qyteti;
- Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare:  
Rr.Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

U dorëzua për shtyp më 7.2.2002  
Doli nga shtypi më 8.2.2002

Tirazhi: 4230 copë

Formati: 60x88/8

Shtypshkronja "Edlor"  
Tiranë, 2002

Çmimi: 150 lekë